

Bashkim Aljji, PhD<sup>1</sup>

UDC: 61(73)(091)

## KONCEPTI I PAQES NË ISLAM

### КОНЦЕПТОТ НА МИРОТ ВО ИСЛАМОТ

### THE CONCEPT OF PEACE IN ISLAM

#### **Abstract**

This paper addresses the Islamic approach to world peace through the Islamic concept of man as a being and explicit commands in the basic sources of Islamic legislation to prioritize peace over war. The paper focuses with emphasis on the practice of the Prophet Muhammad, may God bless him and grant him peace, as the most competent authority for the explanation of the Qur'an, in building peace through concrete examples from his life. In the capacity of the Prophet and the supreme leader of the Muslim community, Muhammad, may God bless him and grant him peace, has made agreements for peace, ceasefire and guarantee of security with various parties. There are two most strategic and symptomatic agreements in this regard: the Medina Charter and the Hodaybiyya Agreement.

This paper explains that an important moment in the life of the Prophet Muhammad, who establishes the Islamic definition of peace, is his participation in the alliance for the protection of the rights of visitors to Mecca, in case they are exposed to robbery, mistreatment and other forms of injustice. This alliance has involved parties with opposite ideological orientations, yet the goal of peace and security of man and society has united them in an alliance. The Prophet Muhammad, may

---

<sup>1</sup> Autori është doktor në fushën e studimeve evropiane për integrim & docent në Universitetin FON. Email: bashkim\_alju@hotmail.ch

peace and blessings of God be upon him, reiterated his readiness to become part of such an alliance for peace and security at all times.

This paper concludes Islam's definition of world peace based on the intellectual nature of God's revelation and the power of speech and call that are conceived as basic mechanisms for conveying Islamic teachings. Only in a calm, peaceful and secure environment, the Islamic platform for building man and society develops in a normal way.

**Keywords:** *peace, Islam, agreement, man, security, cooperation, dialogue.*

## Hyrje

Islami e përfundoi serinë e shpalljeve hyjnore për njerëzimin me zbritjen e mesazhit të fundit hyjnor-Kur'anit, si dhe me dërgimin e të Dërguarit të fundit të Zotit, Muhamedit, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të. Nisma e këtij mesazhi dhe misioni përfundimtar hyjnor për njerëzimin, filloi me fjalë, libër dhe mesazhe me të cilat u frymëzua i Dërguari i fundit i Zotit përmes shpalljes së Kur'anit dhe thënieve të cilat u përçuan si thënie profetike, dhe vazhdoi me fuqinë e fjalës dhe argumentit, pa imponim, pa forcë dhe përdorim të çdo metode tjetër që e tejkalon kufirin e komunikimit me fjalë. Kjo, krahas ambientit të vrazhdët, arrogant dhe dhunues në mjedisin idhujtar arab ku u zhvillua misioni i të Dërguarit të Zotit. Durimi, dialogu dhe komunikimi me palët në mënyrën më të mirë, ka qenë porosia esenciale e Kur'anit për të Dërguarin e Zotit dhe për bashkësinë muslimane në promovimin dhe përçimin e mesazhit islam në shoqërinë arabe ku zbriti shpallja hyjnore, si dhe në çdo shoqëri tjetër në botë, për ku është destinuar mesazhi universal islam. Fillet e misionit islam janë ndërtuar mbi komunikim, dialog në formën më të mirë, tolerancë, durim, paqe dhe maturi, pasi edhe vetë përmbajtja e emrit Islam, në rrënjë, e ka paqen. Islami si fe e bazuar në shpallje, gjegjësisht në libër hyjnor- Kur'anin, që përbën bazë intelektuale, kulturore dhe civilizuese të fesë, i cili komunikon me njerëzit me fjalë, shembuj, argumente dhe dialog, mund të zhvillohet në një rrugë të zakonshme në kushte paqeje, dhe muslimanët, siç shprehet Muhamed Gazali, "Dëshirojnë vetëm paqen, nën hijen e saj ata e realizojnë misionin e tyre të shenjtë të Allahut duke e përmbushur këtë

obligim sa më mirë”.<sup>2</sup> Për këtë, paqja është përcaktim, objektiv dhe ideal i Islamit, apo vlerë që e instalon në disa rrafshe: individual, familjar, komunitar, shoqëror dhe ndërkombëtar. Islami i sheh raportet e njerëzve dhe entiteve në botë në këndin e paqes, mirëkuptimit, sigurisë dhe bashkëpunimit konstruktiv. Megjithatë, koncepti islam për paqen, u kontestua nga palë, të cilët gjykuan për të, përmes veprimeve të disa individëve dhe grupimeve të cilët kanë përkatësi islame, por jo edhe përmes një analize të mirëfilltë të mësimave islame nga burimet e tij autoritative. Ky kontestim dhe konfuzion rreth konceptit Islam për paqen, është sforcuar nga propaganda e fuqishme mediatike në nivel global, ndërkaq është ushqyer nga krizat e njëpasnjëshme që janë ndezur në vendet me shumicë muslimane, në veçanti në Azi. Nisur nga kjo, është e një rëndësie të veçantë të trajtohet koncepti Islam për paqen në dritë të burimeve të tij autoritative.

## I - FORMËSIMI I PAQJES SI PARIM BAZË

### 1. Gjenezja unike e gjinisë njerëzore

Rrënjët e konceptit islam për paqen kthehen në mësimet e tij për gjenezën unike njerëzore, gjegjësisht familjen e parë njerëzore e përbërë nga babai dhe nëna: Ademi dhe Hava. Kjo, ngase gjenezja e përbashkët e gjinisë njerëzore nga një familje, gjegjësisht një baba dhe një nënë, e ngjizë idenë e paqes, dhe mësimi islam për gjenezën unike njerëzore, nxit procese të reproduktimit të ideve dhe pikëpamjeve tolerante, kooperuese, inkluzive, kohezive dhe akomoduese, që do të shërbejnë si orientime bazë për gjeneratat njerëzore në të gjitha stadet e zhvillimit të tyre historik për prodhimin e raporteve dhe situatave unifikuese, të sigurisë dhe stabilitetit, ligjshmërisë në shoqërinë njerëzore, si dhe rinovimin e ndjesisë së gjenezës unike dhe familjes së përbashkët të gjinisë njerëzore, krahas të gjitha dallimeve racore, gjuhësore dhe etnike, ngase në dritë të kësaj ndjesie dhe botëkuptimi, formohet profili i vërtetë i njeriut si qenie kyçe në gjithësi. Në Kur'an kjo shprehet qartë dhe bindshëm: ***“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është***

<sup>2</sup> Gazali, Muhamed, *Komenti tematik i Kur’anit famëlartë*, Logos-A, Shkup, 2007, f.180.

***ruajtur (nga të këqijat) e Allahu është shumë i dijsëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë***<sup>3</sup>

Gjeneza unike njerëzore manifestohet në dy segmente të rëndësishme të ekzistencës së gjinisë njerëzore, të dy këto segmente të artikuluar në shpalljen hyjnore, e që i shërbejnë drejtpërdrejtë konceptit të paqes:

- Njohja: Ndarja e njerëzve në raca, etni, kombe e fise, ka një qëllim të vetëm, atë të njohjes mes tyre, e jo konfliktit dhe luftës për mbijetesë të motivuar nga këto dallime, pasi ata janë anëtarë të një familje, asaj të Ademit dhe Havasë, prindërve të njerëzimit. Këtë e shpreh qartë Kur’ani në fjalët vijuese hyjnore: **“... ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat)...”**<sup>4</sup>

- Dekorimi i qenie njeri: Zoti e ka dekoruar njeriun si qenie njerëzore, pa marrë parasysh dallimet ekzistuese mes tyre, qofshin racore, gjuhësore, etnike, fisnore, lokale, etj. Në Kur’an qëndron: **“Ne, vërtet nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit), u mundësuam të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësuam ata (i lartësuam) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam”**.<sup>5</sup> Pasi njeriu si qenie është i dekoruar nga Krijuesi, nuk i takon vetë njeriut që të iniciojë veprime të cilat e rrënojnë këtë prestigj njerëzor dhe e cenojnë të drejtën e njeriut për të jetuar i lirë, i qetë, i sigurt dhe në paqe.

Interpretimi kosmopolit i këtyre dy segmenteve çon në përfundim racional të tolerancës islame ndaj përcaktimeve të ndryshme të njerëzve dhe mos pengimin e vullnetit dhe lirisë së zgjedhjes së tyre në këtë botë. “Në të vërtetë, kjo fe e mbron njerëzimin nga sjelljet kriminale, duke përfshi edhe diskriminimin. Kjo frymë humanitare ndihmon që të vendoset qetësia universale. Kjo i bashkon racat dhe ngjyrat (e lëkurës) dhe nxit tolerancën e ndërsjellë, sjelljen miqësore dhe dhembshurinë mes njerëzve. Kjo është një mënyrë për pastrimin e atmosferës shoqërore. Kjo i jep mundësi shoqërisë që t’iu shmangen përplasjeve të shkaktuara nga diskriminimi, lufta e fuqive, vetëlartësimi dhe shfrytëzimi material”.<sup>6</sup>

<sup>3</sup> Kur’an, El-Huxhurat: 13.

<sup>4</sup> Kur’an, El-Huxhurat: 13.

<sup>5</sup> Kur’an, El-Isra: 70.

<sup>6</sup> Kutub, op. cit., f.175.

## 2. Urdhri për paqe

Kur'ani, si burim i parë unanim i legjislacionit islam, është i qartë në etablimin e paqes si objektiv i tij esencial, dhe për këtë edhe e urdhëroi të Dërguarin e Zotit, e për rrjedhojë edhe ndjekësit e tij, gjegjësisht pjesëtarët e Islamit, që çdo herë dhe në çdo situatë, të përcaktohen për paqe, e jo për luftë. Kjo vlen edhe për gjendjen para luftimeve, por edhe gjatë luftës, nëse zhvillohen negociata dhe bëhet thirrje për ndërprerje të luftimeve, si dhe ofrohet marrëveshje për paqe. Në Kur'an jepet urdhri vijues: **“Në qoftë se ata anojnë nga paqja, ano edhe ti nga ajo, e mbështetu në Allahun. Ai është që dëgjon dhe di. Po nëse duan të mashtrojnë me të (me paqen), ty të mjafton Allahu. Ai është që të fuqizojë ty me ndihmën e vet dhe me besimtarët.”**<sup>7</sup> Kjo, pasi që Kur'ani, më parë, e urdhëron të Dërguarin e Zotit dhe bashkësinë muslimane që të përgatiten për ta mbrojtur vendin nga sulmet e armiqve, dhe thotë: **“E ju përgatituni sa të keni mundësi force, (mjete luftarake) e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë) e me të (me përgatitje) ta frikësoni armikun e Allahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e Allahu i di ata...”**<sup>8</sup> Ibn Kethiri, duke e komentuar ajetin që urdhron paqe, thotë: “Në qoftë se ata anojnë nga paqja, d.m.th. armëpushimi, pajtimi dhe paqja, edhe ti ano nga paqja dhe pranoje këtë prej tyre. Për këtë, kur idhujtarët kërkuan paqe dhe armëpushim për nëntë vjet me të Dërguarin e Zotit në vitin e Hudejbijes, ai e pranoi ofertën e tyre bashkë me kushtet e tjera që i vunë në këtë kërkesë”.<sup>9</sup>

Në këtë kontekst, Ibn Kethiri shënon se Abdullahu, biri i Imam Ahmedit, transmeton prej Ali ibn Ebi Talibit, se i Dërguari i Zotit ka thënë: **“Vërtet, pas meje do të ndodhin mospajtime apo ndodhi, e nëse mund të bësh paqe, bëje atë”**.<sup>10</sup>

## 3. Doktrina e “Teuhidit”

Themeli bazë i besimit islam është “Teuhidi”, i cili është nocioni themelor i fesë dhe i teologjisë islame; shtylla e parë dhe më kryesore e fesë islame. Thelbi i Teuhidit qëndron në pohimin se Allahu është një dhe i vetmi zot dhe se përveç Tij nuk ekziston ndonjë zot tjetër; Teuhidi

<sup>7</sup> Kur'an, El-Enfal: 61-62.

<sup>8</sup> Kur'an, El-Enfal: 60.

<sup>9</sup> Ibn Kethir, Ismail ibn Omer, *Tefsirul Kur'anil adhim*, botimi i dytë, Daru Tajbe, Rijad, 1999, vëll.IV, f.83.

<sup>10</sup> Po aty.

shpreh natyrën rreptësisht monoteiste të fesë islame.<sup>11</sup> Teuhidi mohon në thelb ekzistimin e më tepër forcave hyjnore që do të derivonin pakënaqësi, konkurrencë dhe mospajtime në krijimin dhe rrjedhën e jetës, si dhe në zhvillimin e botës, e që për pasojë, do të kishte jo stabilitet, përplasje, jo kohezion, trazira dhe turbullira në tokë dhe në shoqëritë njerëzore. Në Kur'an qëndron: **“Sikur të kishte në to (në qiej e në tokë) zota pos Allahut, ato të dyja do të shkatërroheshin...”**<sup>12</sup>; **“Allahu nuk ka marrë për Vete kurrfarë fëmijë (as nga engjëjt, e as nga njerëzit), nuk ka me Të ndonjë zot tjetër, pse (sikur të kishte zot tjetër), atëherë secili zot do të veçohej me atë që ka krijuar, dhe do të dominonte njëri mbi tjetrin!...”**<sup>13</sup> Pikërisht të qenit e gjithësisë, botës, njeriut dhe shoqërisë, krijesë e një Zoti të vetëm që nuk ka ortakë dhe rivalë, “mohon çfarëdo mundësie kundërthëniesh ose papajtueshmërisë në sistemet e tij”,<sup>14</sup> me theks të veçantë, dallimin dhe klasifikimin e qenieve njerëzore në bazë të preferencave gjenetike, racore apo gjuhësore, që do të gjeneronte trazira, turbullira dhe çrregullime në tokë, e që për pasojë, do të zhdukej edhe paqja në shoqëritë njerëzore. Uniteti i Krijuesit e mban harmoninë në gjithësi, në natyrë dhe në jetë, dhe kjo nuk len që në trupat qiellorë në gjithësi dhe në rrjedhën e jetës në përgjithësi, të ketë kundërthënie, plasaritje dhe jo harmoni: **“... Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontrast, andaj, drejto shikimin se a sheh ndonjë çarje?”**<sup>15</sup>

Koncepti i “Teuhidit” monoteizmit dhe mëvetësisë absolute të Krijuesit, i jep sakralitet paqes, kohezionit, rendit dhe sigurisë, duke shenjtëruar paprekshmërinë e jetës dhe qenies njerëzore në veçanti, pasi burimi i jetës dhe vdekjes është ekskluzivisht Krijuesi: **“Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t’ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë...”**<sup>16</sup> “Paqja paraqitet si hyrje në parimin e harmonisë. Paqja do të thotë harmoni në gjithësi, në ligjet e jetës dhe në prejardhjen e

<sup>11</sup> Shih: Murtezai, Ekrem, *Fjalor i terminologjisë fetare*, Dituria Islame, Prishtinë, 2007, f.621.

John L. Esposito e definojnë “Teuhidin” si vijon: “Teuhidi deklaron monoteizmin absolut-unitetin dhe unikshmërinë e Zotit si Krijues dhe Mbajtës i gjithësisë”. Esposito, John L., *Fjalor i Oksfordit për Islamin*, përktheu nga anglishtja: Mimoza Sinani, Logos-A, 2017, Shkup-Prishtinë-Tiranë, f.332.

<sup>12</sup> Kur'an, El-Enbija: 22.

<sup>13</sup> Kur'an, El-Mu'minun: 91.

<sup>14</sup> Kutub, op. cit., f.25.

<sup>15</sup> Kur'an, El-Mulk: 3.

<sup>16</sup> Kur'an, El-Mulk: 2.

njeriut, ndërsa lufta është përfundim i shkeljes së harmonisë si padrejtësi, despotizëm dhe korrupsion”.<sup>17</sup> Nisur nga kjo, koncepti i mëvetësisë së Krijuesit-Teuhidi, synon që ta imunizojë personalitetin e njeriut dhe ta shenjtërojë jetën, paqen dhe sigurinë në shoqëri, të formojë unitet mbarënjëzësor për parimet bazë të jetës njerëzore, ku pa dyshim paqja, siguria dhe stabiliteti shoqëror janë kryefjalë të angazhimit për të formuar një shoqëri të shëndoshë dhe të harmonishme njerëzore, ku çdo njëri e ka mision madhor të mirën për njeriun dhe shoqërinë. Prania e konceptit të mëvetësisë absolute të Krijuesit në doktrinën teologjike islame, përbën bazë legjitime të përfaqësimit dhe angazhimit të komunitetit musliman për paqen botërore dhe promovimin e vlerave njerëzore të pranuar botërisht. Kjo, ngase “Islami e sheh njerëzimin si një familje të madhe të përbashkët dhe si pjesë e bashkësisë së përgjithshme”<sup>18</sup>, ndërkaq doktrina e Krijuesit të mëvetësisë unik, përjashton kategorikisht prishjen e rendit, harmonisë dhe paqes në botë.

#### 4. Refuzimi i teprimit dhe skajshmërive

Islami e refuzon çdo lloj skajshmërie dhe teprimi, dhe kjo qartë shprehet në burimet bazë të Islamit, gjegjësisht në Kur’an dhe në traditën profetike-Sunet, ku hasen nocionet vijuese: El-Guluvu; Mutenettiun; Tesheddud, për denoncimin e skajshmërisë dhe teprimit.

Et-Tenettu’u (stërmundim). Në fjalorët e gjuhës arabe, fjala “tenetea” shpjegohet se ka kuptimin teprim.<sup>19</sup> Në hadith qëndron: “*U shkatërruan ata që stërmundohen, u shkatërruan ata që stërmundohen, u shkatërruan ata që stërmundohen*”.<sup>20</sup> Jusuf el-Kardavi shpjegon: “El-Mutenettiune janë ata që e teprojnë duke u shtrënguar dhe thelluar në zbatimin e fesë aq sa e kalojnë kufirin e mesatares”.<sup>21</sup>

El-Guluvvu (teprimi në fe). Fjala “El-Guluvvu” në gjuhën arabe d.m.th. skajshmëri, teprim, ekzagjerim, zmadhim. Në gjuhën arabe

<sup>17</sup> Kutub, op. cit., f.32.

<sup>18</sup> Kutub, op. cit., f.32.

<sup>19</sup> Shih: Memishi, Isa, *Fjalor Arabisht-Shqip*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2011, vëll.II, f.1859.

<sup>20</sup> Hadithin e shënon Muslimi në përmbledhjen e tij Es-Sahih, libri i dijes, kreu: U shkatërruan ata që stërmundohen, hadithi nr.7. Shih: En Nevevij, Jahja ibn Sheref, *El Minhaxh fi sherhi Sahihi Muslim ibn El Haxhxhaxh*, botimi i parë, Darul kutubil ilmijje, Bejrut, 1995, vëll.XVI, f.180.

<sup>21</sup> Kardavi, Jusuf, *Rizgjimi islam nga adoleshenca drejt pjekurisë*, përkthyes: Nasuf Hoxha, Furkan ISM, Shkup, 2006, f.244.

“gala fi-ddin”, d.m.th., të qenit fetar fanatik<sup>22</sup>, apo ta teprosh në fe. Në hadith qëndron: “*Ruajuni nga teprimi në fe, sepse ata që kanë qenë para jush janë shkatërruar nga teprimi në fe*”.<sup>23</sup>

Et-Tesheddudu (vështirësimi). Në gjuhën arabe fjala “tesheddud” d.m.th., shtrëngim, rreptësi, ashpërsi.<sup>24</sup> Në hadith qëndron: “Mos kërkoni që t’i vështirësoni gjërat që Allahu i Madhërishëm mos t’ua vështirësojë ato, sepse një popull që ia vështirëson vetes, edhe Allahu i Madhërishëm ua vështirëson atyre”.<sup>25</sup>

Skajshmëritë, teprimi dhe jo toleranca, janë veprime të cilat janë në kundërshtim substancial me konceptin e paqes, për atë edhe Islami i refuzon. Me këtë, Islami qartë e trason rrugën e paqes duke mos lënë hapësirë për ithtarët e tij që të mendojnë për rrugë tjera të cilat nuk e kultivojnë dhe mbështesin paqen.

## II - PAQJA, PRAKTIKË PROFETIKE

### 1. Përkrahja e proceseve të paqes dhe lidhja e aleancave

I Dërguari i Zotit, si autoritet më i lartë në komunitetin musliman, gjatë gjithë historisë së tij në krye të këtij komuniteti, po edhe para se ta merr rolin e misionarit të Zotit, ka qenë mbështetës i proceseve të paqes, i ka dhënë përparësi marrëveshjes për paqe ndaj konfliktit, si dhe ka lidhur aleanca me ata që kanë pasur gatishmëri dhe disponim që të bëjnë aleancë me të. Islami e bëri pjesë të vizionit të tij për marrëdhëniet ndërkombëtare respektimin e marrëveshjeve dhe betimeve që jepen për mos shkelje të integritetit të tjerëve. Kjo qartë shihet në urdhrat eksplicit në Kur’an për respektimin marrëveshjeve dhe betimeve, fjala vjen si në

<sup>22</sup> Shih: Memishi, op. cit., f.1334.

<sup>23</sup> Hadithin e shënon Nesaiu në përmbledhjen e tij es-Sunen, libri i rregullave të Haxhit, kreu: Mbledhja e guralecëve që gjuhen në Mina, hadithi nr.3057. Shih: En-Nesai, Ahmed ibn Shuajb ibn Ali, *El-Muxhteba min es-sunen (Sunen en-Nesai)*, Bejtu-l-efkar ed-deulijje, Rijad, pa vit botimi, f.323; dhe Ibn Maxheh në përmbledhjen e tij es-Sunen, libri i rregullave të Haxhit, kreu: Madhësia e guralecëve që gjuhen në Mina, hadithi nr.3029. Shih: Ibn Maxheh, Muhamed ibn Jezid, *Sunenu ibni Maxhe*. Bejtu-l-efkar ed-deulijje, Rijad, pa vit botimi, f.328.

<sup>24</sup> Shih: Memishi, op.cit., vëll.I, f.923-924.

<sup>25</sup> Hadithin e shënon Nesaiu në përmbledhjen e tij es-Sunen, libri i besimit dhe dispozitave të tij, kreu: Feja është lehtësim, hadithi nr.5043. Shih: En Nesai, op. cit., f.516.



ajetet vijuese: “... *Premtimin zbatonie, pse për premtimin ka përgjegjësi*”<sup>26</sup>; “*O ju që besuat! Zbatoni premtimet (obligimet).*”<sup>27</sup>

Në vazhdim, do të përmendim disa ngjarje, sa për ilustrim, që dëshmojnë se Islami i mbështet proceset e paqes dhe lidhjen e marrëveshjeve.

### 1.1. Marrëveshja me fise:

Komuniteti musliman i prirë prej të Dërguarit të Zotit, e pranuan dorën e zgjatur për aleancë nga ana e fisit Huza’a, të cilët në kohën kur ofruan aleancë, ende nuk ishin muslimanë. Kjo marrëveshje e fisit Huza’a me palën muslimane, nën udhëheqjen e të Dërguarit të Zotit, erdhi si rezultat i marrëveshjes së Hudejbijes në vitin e 6 të hixhretit (viti 627 sipas kalendarit Gregorian) në mes të palës muslimane të përfaqësuar prej të Dërguarit të Zotit, dhe palës politeiste mekase të përfaqësuar prej Suhejl ibn Amrit. Marrëveshja i detyronte palët që t’i ndërpresin luftimet për dhjetë vitet e ardhshme dhe gjatë kësaj periudhe duhet të ofrohet siguri për njerëzit duke i pezulluar sulmet ndaj njëritjetrit. Një nga pikat e kësaj marrëveshje parashihte lirinë e përcaktimit të fiseve arabe për të bërë marrëveshje dhe aleancë me cilëndo nga palët nënshkruese të kësaj marrëveshje, muslimanët dhe politeistët mekas. Me këtë rast, fisit Huza’a, bënë marrëveshje dhe lidhën aleancë me të Dërguarin e Zotit, ndërkaq fisi Benu Bekër bënë marrëveshje dhe lidhën aleancë me palën politeiste mekase.<sup>28</sup>

1.2. Mbështetja e paktit për mbrojtjen e personave që u bëhet padrejtësi:

Në muajin Dhul Ki’ëde të vitit 590, atëherë kur Muhamedi, paqja e Zotit qoftë mbi të, kishte njëzet vjet, në Mekë, më saktësisht në shtëpinë e autoritetit të njohur të Mekes, Abdullah ibn Xhud’an, u tubuan krerët e disa familjeve me ndikim në Mekë, si dhe disa familje dhe grupe tjera fisesh aleate të mekasve<sup>29</sup>, të cilët kishin lidhë besë se do të jenë bashkë, si një dorë, me të shtypurit, kundër shtypësve, derisa shtypësi t’ua kthejë të drejtat të shtypurve. Në këtë besëlidhje humane dhe dinjitoze kishte marrë pjesë edhe Muhamedi, paqja e Zotit qoftë mbi të, i cili atëbotë ende

<sup>26</sup> Kur’an, El-Isra: 34.

<sup>27</sup> Kur’an, El-Maide: 1.

<sup>28</sup> Shih: Ibn Hisham, Biografia e Pejgamberit a.s. - version i shkurtuar -, përktheu: Miftar Ajdini, Sira, Prishtinë, 2021, f.265.

<sup>29</sup> Hamidullah, Muhammed, *Muhamedi alejhisselam – jeta dhe vepra* -, përktheu nga frengjishtja: Ruzhdi Ushaku, Logos-A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2011, vëll.I, f.53.

nuk ishte ngarkuar me misionin e pejgamberisë, por, më vonë, është shprehur se pjesëmarrja në këtë besëlidhje për të ka qenë nder, dhe nuk do ta kishte ndërruar këtë besëlidhje as për një tufë devesh qimekuqe, dhe se po ta ftonin do të shkonte sërish.<sup>30</sup> Edhe pse palë të kësaj besëlidhje nuk kanë qenë vetëm muslimanët, por pasi bëhej fjalë për proces paqeje dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut, i Dërguari i Zotit u shpreh se ka qenë nder për të pjesëmarrja në një marrëveshje të këtillë, dhe se edhe tash sikur të thirrej, do të merrte pjesë.

1.3. Karta e Medines: “Karta e Medines” është një dokument historik i cili është përpiluar nga ana e profetit Muhamed, paqja e Zotit qoftë mbi të, pas shpërnguljes së tij në Medine, me të cilin dokument rregulloheshin të drejtat dhe obligimet e bashkësive ekzistuese në Medine, në shtetin e ri, i cili udhëhiqej nga vetë profeti Muhamed, paqja e Zotit qoftë mbi të, si lider shpirtëror dhe politik. Karta e Medines është dëshmi e qartë e përcaktimit të Islamit, përmes praktikës profetike, për paqe, stabilitet, siguri, marrëveshje, komunikim me pjesëtarët e feve tjera, tolerancë ndaj tyre, mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe avancim të proceseve të paqes. Karta e Medines, si dokument legjislativ, i rregullonte marrëdhëniet e të gjitha bashkësive në shtetin e ri të formuar në Medine edhe në segmentin e sigurisë, si një nga segmentet më të ndjeshme të shtetit, përfshi këtu edhe bashkësinë hebreje. Kjo ishte e theksuar në mënyrë eksplicite në vetë nenet e Kartës së Medines, dhe disa nene të këtij dokumenti i referohen aspektit të sigurisë së shtetit, gjegjësisht rolit të bashkësive në hartimin e politikës së sigurisë në shtetin musliman të Medines.<sup>31</sup> Kjo kartë është një dokument i shkruar që dëshmon për përcaktimin e të Dërguarit të Zotit për paqe me bashkësitë tjera fetare dhe etnike, gatishmërinë e tij që të bëjë marrëveshje me palët për ta garantuar sigurinë e tyre dhe kohezionin shoqëror në vend, si dhe për t’i shtyrë përpara proceset paqësore dhe integruese në shoqëri.

## **2. Thirrja me butësi dhe durimi në prova**

I Dërguari i Zotit ka pasur instruksione të qarta nga Krijuesi që misioni dhe veprimtaria e tij në mesin e njerëzve të jetë në frymë tolerante, përgëzuese, mirëkuptimi, butësie dhe bashkëpunimi, me të gjithë, për atë që është e vlefshme dhe e dobishme për njerëzimin, pa

---

<sup>30</sup> Po aty.

<sup>31</sup> Shih për pikat e kësaj marrëveshjeje: Ibn Hisham, op. cit., f.146.

marrë parasysh përkatësinë e tyre fetare. Kjo thirrje manifestohet në tri rrafshë kyçe:

### II.2.1. Komunikimi me njerëzit me butësi dhe pa ashpërsi:

Krijuesi e ka urdhëruar të Dërguarin e tij, Muhamedin, paqja e Zotit qoftë mbi të, që t'ua prezanton mësimet islame dhe besimin islam njerëzve, me butësi, me urtësi, pa imponim dhe jo me vrazhdësi. Në Kur'an qëndron: **“Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira.”**<sup>32</sup> Në një rast tjetër, Kur'ani flet se Zoti ia tërheq vërejtjen të Dërguarit të Tij që mos të jetë i ashpër dhe arrogant me njerëzit, ngase kjo do të shkaktonte neveri dhe do t'i largonte njerëzit prej tij. Në Kur'an qëndron: **“Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet...”**<sup>33</sup> I Dërguari i Zotit në shumë thënie të tij ka folur për rëndësinë e butësisë në komunikim me njerëzit, e në një thënie të tij, shprehet kështu: “Allahu e do mirësinë dhe butësinë në çdo punë e në çdo gjë”.<sup>34</sup>

Imponimi i besimit dhe pikëpamjeve, nuk pranohet në Islam, dhe këtë vetë Zoti ia thotë të Dërguarit të Tij në Kur'an: **“E ti pra, këshillo, se je vetëm përkujtues. Ti ndaj tyre nuk je mbizotërues!”**<sup>35</sup> Në Kur'an, qartë urdhërohet i Dërguari i Zotit që të jetë durimtar ndaj vështirësive që i dalin në rrugë si misionar, dhe mos të bëj veprime që nuk përkojnë me misionin e tij. Në Kur'an qëndron: **“Dhe për hir të Zotit tënd duro!”**<sup>36</sup>; **“Dhe kij durim ndaj asaj që të thonë dhe largohu atyre i matur.”**<sup>37</sup>

### 2.2. Dialogimi me ithtarët e librit në mënyrën më të mirë:

Zoti e urdhëron të Dërguarin e Tij në Kur'an që jo vetëm të dialogojë me ithtarët e librit- hebrenjtë dhe të krishterët, por këtë ta bëjë në mënyrën më mirë. Në Kur'an e lexojmë ajetin që qartë e urdhëron këtë për të Dërguarin e Zotit: **“Ithtarët e librit mos i polemizoni**

<sup>32</sup> Kur'an, En-Nahl: 125.

<sup>33</sup> Kur'an, Ali Imran: 159.

<sup>34</sup> Hadithin e ka transmetuar Buhariu në *Sahih-un* e tij, libri i etikës dhe mirësjelljes, kapitulli: Mirësia dhe butësia për çdo punë. Shih: Zebidi, op. cit., f.610, hadithi nr.2016.

<sup>35</sup> Kur'an, El-Gashije: 21-22.

<sup>36</sup> Kur'an, El-Mudethir: 7.

<sup>37</sup> El Muzzemmil: 10.

*ndryshe vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thuajuni: Ne i besuam asaj që na u zbrit neve dhe që u zbrit juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij*".<sup>38</sup> Dialogimi në mënyrën më të mirë, nuk i referohet vetëm ithtarëve të librit, por të gjithë pjesëtarëve të feve dhe besimeve tjera, kushdo qofshin ata. Në Kur'an qëndron: *"Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira"*.<sup>39</sup>

2.3. Bashkëpunimi për çështje të dobishme, dhe bamirësia ndaj atyre që nuk na kanë bërë dëme:

Islami nuk e sheh bashkëpunimin për gjëra të dobishme dhe produktive me palët tjera në bazë të përkatësisë fetare, por, bashkëpunimi me palët e tjera, shihet nga këndi i pozitivitetit dhe konstruktivitetit, gjegjësisht pranohet bashkëpunimi në bamirësi dhe devotshmëri, edhe nëse realizohet me palë që nuk i takojnë besimit Islam. Në Kur'an lexojmë: *"Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e në armiqësi..."*<sup>40</sup> Po ashtu, Islami nuk ndalon që të të jemi bamirës ndaj pjesëtarëve të feve tjera, nëse nuk janë në gjendje lufte me ne dhe nuk na bëjnë padrejtësi. Në Kur'an qëndron: *"Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë. Allahu ju ndalon t'u afroheni vetëm atyre që ju luftuan për shkak fesë, që ju nxorën prej shtëpive tuaja dhe që ndihmuan dëbimin tuaj; ju ndalon të miqësoheni me ta. Kush miqësohet me ta, të tillët janë dëmtues të vetvetes"*.<sup>41</sup>

Të gjitha këto elemente që u përmendën, e që përbëjnë vetëm një pjesë të lëndës që trajton qëndrimin e muslimanit ndaj pjesëtarëve të feve dhe besimeve tjera, flasin se paqja është përcaktimi i Islamit, ngase urdhri drejtuar të Dërguarit të Zotit për durim, dialogim me pjesëtarët e besimeve tjera në mënyrën më të mirë, komunikim me njerëzit në përgjithësi me butësi dhe maturi, si dhe durimi në sprova dhe vështirësi gjatë këtyre proceseve, është argument bindës në këtë drejtim, ngase vetëm me këto elemente mund të arrihet paqe, e jo ndryshe.

<sup>38</sup> El-Ankebutë: 46.

<sup>39</sup> Kur'an, En-Nahl: 125.

<sup>40</sup> Kur'an, El-Maide: 2.

<sup>41</sup> Kur'an, El-Mumtehine: 8-9.

## CONCLUSIONS

- Peace is the strong foundation of Islamic doctrine, as the divine message addressed to mankind came through The Book - The Qur'an, and this represents the greatest intellectual miracle the last Messenger of God, Muhammad, may peace and blessings of God be upon him was distinguished with.

- The conveyer of the last divine message to the people, Muhammad, peace and blessings of God be upon him, is described in the Qur'an as "mercy for the worlds", a premise that defines peace as the essential definition and orientation of Islam in building the relationships of the Muslim community with other parties.

- Fulfillment of agreements and commitments with the parties has been established as a criterion of interpersonal relations in Islam and an obligation for the Muslim in international relations

- The Messenger of God has been the most prominent example of the implementation of this criterion, which is evidenced in all the agreements and commitments he has made. He has remained faithful to all of them and has implemented them accurately. Violations have occurred from the opposite side.

- The Messenger of God best implemented the concept of peace in Islam by making a series of agreements, pushing forward and supporting the peace process. Special emphasis should be put on the "Charter of Medina", the "Agreement of Hudaibiyyah" and the participation in the "Covenant to help the people who suffered injustice in Mecca".

- Peace is established as an essential objective of Islam, which is clearly seen in the explicit Qur'anic command to "lean towards peace", and to give peace a chance instead of war.

## Literatura

Kur'ani, përktheu dhe komentoi në gjuhën shqipe: Sherif Ahmeti. Bulaç, Ali, *Koncepte dhe sisteme bashkëkohore*, Logos-A, Shkup, 2005.

Emon, Anver M., *Teoritë e ligjit natyror Islam*, përktheu nga anglishtja: Nejona Kadzadej, Logos-A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2015.

Esposito, John L., *Fjalor i Oksfordit për Islamin*, përktheu nga anglishtja: Mimoza Sinani, Logos-A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2017.

Gazali, Muhamed, *Komenti tematik i Kur'anit famëlartë*, përktheu: Sadush Tahiri, Logos-A, Shkup, 2007.

Hamidullah, Muhammed, *Muhamedi alejhisselam – jeta dhe vepra* -, përktheu nga frengjishtja: Ruzhdi Ushaku, Logos-A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2011.

Hamidullah, Muhamed, *Hyrje në Islam*, përktheu nga sërbo-kroatishtja: Bahri Aliu, Neshat Xheladini, Kryesia e Bashkësisë Islame për RSM- Shkup, 1985.

Ibn Hisham, *Biografia e Pejgamberit a.s. - version i shkurtuar* -, përktheu: Miftar Ajdini, Sira, Prishtinë, 2021.

Ibn Kethir, Ismail ibn Omer, *Tefsirul Kur'anil adhim*, botimi i dytë, Daru Tajbe, Rijad, 1999.

Ibn Maxheh, Muhamed ibn Jezid, *Sunenu ibni Maxhe*. Bejtu-l-efkar ed-deulijje, Rijad, pa vit botimi.

Kardavi, Jusuf, *Rizgjimi islam nga adoleshenca drejt pjekurisë*, përkthyes: Nasuf Hoxha, Furkan ISM, Shkup, 2006.

Kureshi, Sultan Ahmed, *Letrat e Muhammedit a.s.*, përktheu nga anglishtja: Mimoza Sinani, Logos-A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2015.

Kutub, Sejjid, *Islami dhe paqja universale*, përktheu nga anglishtja: Agim Mullafetahu, Asr, Tetovë, 2005.

Memishi, Isa, *Fjalor Arabisht-Shqip*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2011.

Murtezai, Ekrem, *Fjalor i terminologjisë fetare*, Dituria Islame, Prishtinë, 2007.

En-Nesai, Ahmed ibn Shuajb ibn Ali, *El-Muxhteba min es-sunen (Sunen en-Nesai)*, Bejtu-l-efkar ed-deulijje, Rijad, pa vit botimi.

En Nevavij, Abdul Halik, *El alakatu ed devlijje ve en nudhumu el kadaijje fi esh sheria'til islamijje*, botimi i parë, Darul kitabil arebijj, Bejrut, 1974.

En Nevevij, Jahja ibn Sheref, *El Minhaxh fi sherhi Sahihi Muslim ibn El Haxhxhaxh*, botimi i parë, Darul kutubil ilmijje, Bejrut, 1995.

Sa'd, Ferhat Abdul Atij, *Es Sijase esh sheri'jje*, Darul Endelus el hadrae, Xheda, 2005.

Es Sehmerani, Es'ad, *El Ahlaku fil Islam vel felsefetil kadime*, botimi i parë, Daru en nefais, Bejrut, 1988.

Zebidi, Zejnudin Ahmed ibn Abdul-Latif, *Muhtesar Sahih El Buhari*, përktheu nga arabishtja: Telat Sula, botimi i katërt, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, 2016.